

VENDIM
Nr. 1034, datë 16.12.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 658, DATË 26.9.2012, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E
PRONAVE TË PALUAJTSHME NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nenin 6, të aneksit 1, të vendimit nr. 658, datë 26.9.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pika 1 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“1. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, brenda datës 31 mars të çdo viti, përpunon të dhënat e vitit paraardhës, të dërguara zyrtarisht nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, duke i grupuar ato sipas zonave kadastrale, nënndarjes brenda zonës apo bashkimeve të dy apo më shumë zonave kadastrale, për qëllim të përlogaritjes së vlerës së pasurive të paluajtshme, sipas llojit të pasurisë, ndarjes dhe nënndarjeve të saj, dhe i propozon ministrit të Drejtësisë vijimin e procedurave për miratimin e tyre nga Këshilli i Ministrave.”.

2. Pika 4 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“4. a) Në rast se për një zonë kadastrale, nënndarje apo bashkim të tyre, mungojnë transaksionet për një ndarje apo nënndarje të llojit të pasurisë së paluajtshme, atëherë përcaktimi i vlerës për këto zona do të bëhet mbi bazën e metodës indirekte, duke i grupuar kontratat e shitjes në një nivel më të afërt, sipas kësaj radhe: fshat, qytet, bashki, qark, për atë grup të llojit të pronës.

b) Në rast se për një zonë kadastrale, nënndarje apo bashkim të tyre nuk arrihet të përcaktohet vlerë, edhe pas përpunimit të të dhënave mbi bazën e metodës indirekte, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën “a”, atëherë vlera e pasurisë së paluajtshme për atë zonë kadastrale do të jetë vlera përkatëse, e përcaktuar në vendimin paraardhës të Këshillit të Ministrave.”.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama